

RAPORT ANALITIK

SHOQËRIA CIVILE DHE TRANSPARENCA BUXHETORE *FORCIMI I ADVOKIMIT DHE PJESËMARRJES PUBLIKE*



Funded by
the European Union



Budget
Accountability
and Transparency

Autorja: Rezarta Caushaj

2025

Botues: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Rr. Shenasi Dishnica,
Nd. 35, H. 1, 1017, Tirana, Albania P.O.Box 8177. Email: info@idmalbania.org
| Website: idmalbania.org

Riprodhimi i pjesëve të këtij botimi lejohet vetëm duke cituar burimin original.

Ky dokument është prodhuar në kuadër të nismës “BAT Civil Society”, e zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin vetëm autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrimet e Bashkimit Evropian.



Institute
for Democracy
and Mediation



Center for
Research and
Policy
Making

... policy impact since 2004



Fakt@je.al

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| I. Hyrje | 05 |
| II. Konteksti i transparencës buxhetore në Shqipëri | 06 |
| III. Përparimet e shoqërisë civile në promovimin e transparencës buxhetore | 10 |
| IV. Mësime të nxjerra nga përparimet e shoqërisë civile | 18 |
| V. Rekomandime për një advokim buxhetor më efektiv | 22 |

I. Hyrje

Transparenca buxhetore është një element kritik i qeverisjes së mirë dhe mjet për garantimin e llogaridhënies dhe përfshirjes qytetare në proceset demokratike. Megjithë progresin e shënuar dhe antarësimin e vendit në Iniciativën Globale të Transparencës Fiskale, procesi buxhetor në Shqipëri vuan rutinisht nga institucione të mbyllura dhe angazhimi i pamjaftueshëm i qytetarëve, të cilat kufizojnë mundësitë për një kontroll efektiv të shpenzimeve publike. Për më tepër, transparenca buxhetore përgjithësisht kufizohet vetëm në kontrollin e shpenzimeve publike, ndërsa nuk ka asnjë rregullim apo praktikë edhe kontrolli në anën e të ardhurave buxhetore.

Shqipëria ka krijuar një kuadër të plotë ligjor që rregullon pjesmarrjen e publikut në të gjithë fazat e procesit buxhetor: në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e tij. Ligji Ligji Nr.9936, datë 26.6.2008 (me amendime) për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, Ligji Nr. 139/2015 Për vetqeverisjen vendore, Ligji Nr. 68/2017 Për financat e vetqeverisjes vendore, Ligjin Nr. 119/2014 Për të Drejtën e Informimit. dhe LIGJ Nr. 146/2014 Për njoftimin dhe konsultimin publik, ofrojnë mundësi për transparencë dhe llogaridhënie, por zbatimi i tyre ka rezultuar i dobët. Institucionet shpesh nuk publikojnë të dhëna të plota, në kohë apo në formate lehtësisht të aksesueshme, duke vështirësuar monitorimin nga shoqëria civile dhe qytetarët. Për më tepër, kapacitetet e pamjaftueshme financiare dhe teknike të organizatave lokale, si dhe niveli i ulët i ndërgjegjësimit qytetar, kanë izoluar ndikimin potencial të këtyre iniciativave.

Në këtë kontekst, shoqëria civile në Shqipëri ka qenë një forcë shtytëse në promovimin e transparencës buxhetore, duke adresuar mungesat në zbatimin e kuadrit ligjor dhe duke nxitur përfshirjen qytetare në proceset buxhetore. Organizata të tilla si Instituti për Studime Urbane, UN Women Albania, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), AIS/Open Data Albania, Partners Albania, Europartners, Qendra Kombëtare Burimore apo Fondacioni Down Syndrome Albania (DSA), kanë ndërmarrë iniciativa të ndryshme, përfshirë trajnime, krijimin e platformave digjitale, organizim të dëgjësive publike, projekte për buxhetimin me pjesëmarrje dhe monitorime të buxheteve dedikuar kategorive specifike.

Ky punim analizon përpjekjet e shoqërisë civile në Shqipëri në këtë drejtim, të identifikojë sfidat dhe të nxjerr disa mësimë nga këto iniciativa si dhe ofron rekomandime për strategji advokimi më efektive, - me qëllimin fundor pikërisht rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare në proceset buxhetore.

II. Konteksti i transparencës buxhetore në Shqipëri

Shqipëria ka krijuar një kuadër ligjor që synon të promovojë transparencën dhe llogaridhënien buxhetore, me një bazament të hedhur në Kushteturen e vendit dhe legjislacioni specifik si Ligji Nr.9936, datë 26.6.2008 (me amendime) për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, Ligji Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligji Nr. 68/2017 Për financat e vetqeverisjes vendore, Ligjin Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe Ligj Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Neni 100 i Kushtetutës përcakton rolin e Këshillit të Ministrave për miratimin dhe menaxhimin e buxhetit të shtetit, duke vendosur bazën për llogaridhënien buxhetore. Kushtetuta përcakton gjithashtu rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) si institucion suprem për mbikëqyrjen e financave publike, duke garantuar transparencë dhe llogaridhënie.

Ligji për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor është baza kryesore për menaxhimin e financave publike në Shqipëri. Ai përcakton procedurat për përgatitjen, miratimin, ekzekutimin dhe raportimin e buxhetit të shtetit. Ai përcakton detyrimet për transparencë, duke kërkuar publikimin e dokumenteve buxhetore dhe raportimin periodik të shpenzimeve. Parimet themelore të funksionimit të sistemit buxhetor, të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji janë:

- Transparenca, parashikueshmëria, gjithëpërfshirja, uniteti dhe universalitetin e menaxhimit të sistemit buxhetor e të fondeve speciale;
- Disiplina fiskale, në përputhje me stabilitetin makroekonomik dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social;
- Shpërndarja e burimeve, në përputhje me objektivat strategjike të Këshillit të Ministrave;
- Përdorimi ekonomik, eficient dhe efektiv i burimeve publike;
- Përgjegjësi të qarta për menaxhimin operacional;
- Respektimi me rreptësi i tërësisë së procesit;
- Barazia gjinore, e cila i referohet situatës ku burri dhe gruaja gëzojnë mundësi dhe akses të barabartë në të drejta dhe përfitime të së njëjtës natyre.

Ligji “Për të drejtën e informimit” garanton aksesin e qytetarëve në informacionet publike, përmes përcaktimit të kategorive të informacionit të detyrueshëm për publikim, si regjistrat e prokurimeve publike dhe pasqyrat financiare. Neni 7 i këtij ligji detyron autoritetet publike të publikojnë Programin e Transparencës, i cili përfshinë informacione mbi buxhetin dhe shpenzimet publike.

Informacioni duhet të jetë i plotë, i saktë, i përditësuar dhe lehtësisht i aksesueshëm.

Ndërkohë, Ligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik” orienton procesin e konsultimit publik mes organeve publike dhe palëve të interesuara për projektligje, dokumente strategjike dhe politika publike, duke caktuar afate e modalitete për konsultimin e qytetarëve.

Një tjetër ligj me rëndësi është Ligji Nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” (i ndryshuar) përcakton rolin, organizimin dhe funksionet e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) në Shqipëri, si institucion kushtetues dhe i pavarur, për auditimin e financave publike dhe garantimin e efikasitetit të përdorimit të parave të taksapaguesve.

Ky kuadër plotësohet periodikisht, - përveç një sërë ligjesh të tjera, - edhe nga dokumente të rëndësishme ndërsektoriale si Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike dhe Plani i Veprimit, që përcaktojnë objektiva specifike për përmirësimin e raportimit të performancës së buxhetit e transparencës nga ana institucioneve.

Të njëjtat parime të menaxhimit të financave publike dhe detyrime për informim dhe konsultim publik janë përcaktuar dhe në legjislacionin që rregullojnë veprimtarinë e autoriteteve lokale dhe të financave vendore.

Megjithatë, zbatimi i këtyre ligjeve është i dobët. Institucionet publike, përfshirë Ministrinë e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore, shpesh nuk respektojnë afatet për

publikimin e dokumenteve buxhetore ose i publikojnë ato në formate të vështira për t'u kuptuar nga publiku i gjerë. Për shembull, raportet vjetore të zbatimit të buxhetit shpesh publikohen me vonesë, dhe të dhënat e detajuara për shpenzimet specifike mungojnë ose janë të fragmentuara. Kjo kufizon aftësinë e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar dhe vlerësuar performancën buxhetore.

Ligji mbi të drejtën e informimit vuan nga mungesa e vullnetit institucional për ta zbatuar. Një raport i IDM-së i vitit 2021, që ka monitoruar zbatimin e Programit të transparencës në bashkitë që janë qendër qarku, - me ndihmën e 12 organizatave lokale, - zbuloi se shumica e bashkive kryesore në vend publikojnë rregullisht informacion në lidhje me planin e buxhetit vjetor dhe dokumentacionin përkatës. Ato ngelen mbrapa kur bëhet fjalë për të ofruar të njëjtin nivel transparence mbi zbatimin dhe monitorimin e realizimit të buxhetit. Vetëm 3 nga 10 bashki publikojnë raportet periodike për realizimin e treguesve të buxhetit, 4 nga 10 publikojnë raportet e monitorimit të kontratave publike dhe vetëm gjysma publikojnë regjistrin e realizimit të procedurave të prokurimit.

Ngjashëm regullimi i konsultimit publik me ligj shënoi në vetvete një hap para për përfshirjen e grupeve të interesit në vendimmarrje, por shoqëria civile dhe media kanë konstatuar se ligji ka nevojë për përmirësim, pasi i jep diskrecion të madh institucioneve të vendosin formën e

konsultimeve, vendin dhe kush merr pjesë në to. Një studim i ndërmarr nga IDM-ja në 2024 për zbatimin e tij përgjatë 10 viteve, - qyshkur ligji ka hyrë në fuqi në 2014, - zbuloi një sërë problemesh, si:

- a. mungesa e planifikimit të dëgjësive;
- b. mungesa e konsultimeve paraprake;
- c. metoda konsultimi e afate që nuk i përshtaten natyrës së grupeve të synuara apo kompleksitetit të ccështjes në diskutim;
- d. përjashtim të grupeve informale të shoqërisë civile nga procesi;
- e. mungesë monitorimi e raportimi mbi procesin e konsultimeve;
- f. mungesë përcaktimit të kompetencave të koordinatorëve të konsultimit;
- g. transparenca e dobët e dokumenteve mbështetës.

Një tjetër problem i konstatuar nga ResPublica qysh në raportin fillestar të monitorimit të ligjit është mungesa e sanksioneve administrative ndaj organit apo personit përgjegjës mbi njoftimin dhe konsultimin publik. Ndërkohë që një monitorim i mëvonshëm, publikuar në 2019, tregoi se gjysma e projektligjeve të kaluar në Kuvend nuk i ishin nënshtruar konsultimit publik.

Gjetjet e mësipërme rezonojnë me një tjetër dokument politikash të botuar nga IDM në 2021, ku argumentohet se në vend, prej vitit 2016, kemi pasur një zbrapsje në nivelin e demokracisë dhe tkurrje të angazhimit qytetar.

Sfidë më vetë përbën edhe angazhimi i ulët i qytetarëve në proceset buxhetore. Sipas indeksit të botuar nga Open Budget Survey (OBS, 2023), pjesmarrja e publikut në procesin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit vlerësohet me 9 pikë (nga 100), duke qenë larg mesatares botërore që vlerësohet me 15 pikë. Pjesmarrja e publikut është veçanërisht inekzistente në procesin e zbatimit dhe monitorimit/auditimit. Pavarësisht mundësive ligjore për dëgjesa publike dhe konsultime, pjesëmarrja qytetare mbetet minimale, kryesisht për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit dhe besimit të institucionet. Qytetarët shpesh perceptojnë procesin buxhetor si të ndërlikuar dhe të largët nga nevojat e tyre të përditshme. Kjo situatë përkeqësohet nga mungesa e kapaciteteve të institucioneve lokale për të organizuar konsultime efektive dhe për të komunikuar në mënyrë të qartë me publikun.

Një tjetër sfidë është cilësia e dobët e të dhënave buxhetore. Edhe kur publikohen, të dhënat shpesh nuk janë në formate të hapura ose të lehta për t'u analizuar, duke e bërë të vështirë për organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët të kryejnë monitorime të pavarura. Për shembull, platforma online e Ministrisë së Financave ofron informacion të kufizuar për shpenzimet specifike, ndërsa njësitë e qeverisjes vendore rrallë publikojnë raporte të detajuara për buxhetet e tyre.

Kjo mungesë transparence pengon llogaridhënien dhe rrit rrezikun e keqpërdorimit të fondeve publike.

Ministria e Financave luan një rol qendror në procesin buxhetor, por performanca e saj në promovimin e transparencës është e

pamjaftueshme. Për shembull, platforma e saj online, e cila synon të ofrojë informacion mbi buxhetin, është e kufizuar në funksionalitet dhe shpesh nuk përditësohet rregullisht. Në nivel lokal, bashkitë përballen me sfida të ngjashme, ku mungesa e burimeve dhe ekspertizës kufizon aftësinë e tyre për të përfshirë qytetarët dhe për të publikuar të dhëna të plota buxhetore. Kjo situatë përkeqësohet nga mungesa e koordinimit mes institucioneve qendrore dhe lokale, duke krijuar një boshllëk në zbatimin e politikave të transparencës.

Po ashtu, institucione si Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin e shpenzimeve publike, por atyre u mungon elementi thelbësor që garanton efikasitetin e punës së tyre: pavarësia nga ndërhyrjet politike. Raportet e KLSH-së nuk pasohen nga veprime konkrete nga ana e qeverisë, e cila nuk duhet të shqetësohet për një presion të mundshëm nga Parlamenti, për shkak të dominimit të tij me anë të numrave. Po ashtu, pavarësia çënohet jo pak edhe nga kalimi i ligjeve me porosi, të cilat gërryejnë autoritetin e institucionit, siç zbulon raporti i Gjergji Vurmo-së i vitit 2021. Këto probleme vetëm përkeqësohen nga mungesa e një kornize bashkëpunuese serioze me shoqërinë civile, që do të shërbente si kundërpeshë ndaj pasivitetit të Parlamentit. Përfundimi ka qënë mungesa e llogaridhënies institucionale, që ka minuar besimin e publikut dhe kufizuar efektivitetin e mekanizmave të pavarur të kontrollit.

Sipas Indeksit të Buxhetit të Hapur të vitit 2023, në transparencën buxhetore Shqipëria renditet në vendin e 57 nga 125 vende të

përfshira në analizë, dhe në vendin e 67 në fushën e monitorimit të buxhetit, duke qëndruar nën nivelin e mjaftueshëm të pikëve për tu klasifikuar si një vend me transparencë të mirë buxhetore. Sipas metodologjisë së OBS që publikon këtë indeks, vendi që merr mbi 61 pikë dëshmon se vendi publikon materiale të mjaftueshme për të mbështetur pjesëmarrjen aktive të publikut në procesin buxhetor, ndërkohë që vendi ynë ka marrë vetëm 46 pikë. Kjo shifër edhe pse me një përmirësim krahasuar me vitet e mëparshme, mbetet larg standardeve të vendeve me qeverisje të hapur, si Zelanda e Re apo Suedia, të cilat shënojnë mbi 80 pikë. Mungesa e publikimit të dokumenteve kyçe, si raportet e auditimit në kohë reale dhe planet afatgjata të buxhetit, kontribuon në këtë renditje. Raporti i OBS-së gjithashtu ka arritur në përfundimin se vendet me transparencë të mjaftueshme buxhetore, mbikqyrje të përshtatshme dhe mundësi të mira për pjesëmarrje qytetare shfaqin rezultate më të mira në treguesit e tjerë ekonomik, social dhe politik.

Si përfundim, konteksti i transparencës buxhetore në Shqipëri karakterizohet nga një kuadër ligjor premtues, por me zbatim të dobët dhe sfida të mëdha në angazhimin qytetar dhe cilësinë e të dhënave. Krahasimi me standardet ndërkombëtare dhe vendet e rajonit tregon se ka hapësirë për përmirësime të konsiderueshme, veçanërisht në publikimin e të dhënave të hapura dhe në përfshirjen e qytetarëve. Këto sfida krijojnë një mundësi unike për shoqërinë civile për të mbushur boshllëqet dhe për të nxitur një qeverije më të hapur dhe llogaridhënëse.

III. Përprojekjet e shoqërisë civile në promovimin e transparencës buxhetore

3.1

BUXHETIMI ME Pjesëmarrje

Në thelb të çdo fushate të ndërrmarr nga shoqëria civile për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në financat publike në vend, për gati dy dekada, qëndron koncepti i buxhetimit me pjesëmarrje (BP). Ky koncept u zbatua për herë të parë me rezultate mbresëlënëse në Porto Alegre të Brazilit në vitin 1990 dhe në pikun e tij, në vitin 2002, arriti të angazhonte direkt në ciklin buxhetor 17,200 qytetarë dhe të shpërndante një buxhet prej 160 milionë dollarësh. Bëhet fjalë për një proces në të cilin qytetarët vendosin ose influencojnë direkt mënyrën se si do të shpenzohet një pjesë e buxhetit lokal. Sot BP zbatohet në rreth 2700 njësi të qeverisjes lokale në botë, përfshi edhe disa bashki të mëdha në Shqipëri si Durrësi, Elbasani, Korça, Berati apo bashki më të vogla si Cerriku e Puka, ndonëse shpesh togëfjalëshi është instrumentalizuar nga institucionet, jo për të rritur, por për të shmangur llogaridhënien.

Projekti u pilotua në Shqipëri nga Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) në vitin 2005, me mbështetjen e aktorëve ndërkombëtarë si Banka Botërore dhe Oxfam.

Qëllimi ishte hedhja e themeleve për një proces buxhetimi me pjesëmarrje duke përgatitur zyrtarët vendorë dhe organizatat për të konsultuar e përfshirë qytetarët në ciklin e planifikimit buxhetor. Banka Botërore, përmes programit të saj të granteve të vogla (Civil Society Fund), ofroi financim për të mbështetur këtë iniciativë, duke synuar forcimin e dialogut mes qytetarëve dhe autoriteteve vendore.

Në vitet 2007 - 2009 IKU bashkëpunoi me International Budget Partnership, duke hulumtuar mbi nivelin e transparencës së institucioneve në lidhje me procesin e buxhetimit e duke informuar renditjen e vendit në Indeksin e Buxhetit të Hapur.

Ndërsa, në 4 vitet e ardhshme organizata u angazhua në projekte të buxhetimit me pjesëmarrje, veçanërisht në bashkitë, si Korça e Pogradeci. Bashkëpunimi me aktorë lokalë prodhoi një kornizë formale të buxhetimit me pjesëmarrje, që u finalizua me publikimin e një pakete mjetesh (toolkit) për autoritetet lokale në Shqipëri.

Pas vitit 2010, u intensifikuan përprojekjet për të përfshirë grupet e marginalizuara, si komuniteti rom, në proceset e buxhetimit me pjesëmarrje. Ndërsa, me miratimin e Reformës së re Administrative në vitin 2015,

IKU arriti të institucionalizonte disa praktika të buxhetimit me pjesëmarrje në disa bashki, si ajo e Matit, Vaut të Dejës, Kukësit, Lezhës, Klosit, Tropojë, Malësisë së Madhe e Shijakut, duke bashkëpunuar për Hartimin e Paketës Fiskale, Buxhetit Vjetor dhe Programit të Buxhetit Afatmesëm.

Organizata ishte e para që gjithashtu aplikoi monitorimin e zbatimit të buxheteve lokale apo buxheteve në sektorë të targetuar, si bujqësia, për të rritur financimin dhe transparencën buxhetore të institucioneve, teksa ka vijuar të punojë për të integruar buxhetimin me pjesëmarrje në strategjitë ndërsektoriale të zhvillimit lokal.

Ndërsa përpjekje kishin filluar të jepnin frytet e para, organizatat e shoqërisë civile kishin nevojë për investim në rritjen e kapaciteteve të tyre për t'u përfshirë e për të udhëhequr përfshirjen e komuniteteve lokale në planifikimin e buxhetit apo për të raportuar mbi performancën e tij.

Një iniciativë që synonte kapërcimn e këtyre pengesave ishte ajo e Partners Albania, mbështetur nga Olof Palme International Center dhe Fondacioni për Shoqëri të Hapur (OSFA) në 2015, ku në fokus ishte buxhetimi me pjesëmarrje përcështje që preknin të rinjtë, arsimin, sportin dhe mbrojtjen sociale në rang kombëtar. Partners u angazhua në trajnimin e 22 organizatave të shoqërisë civile nga qytete të ndryshme të vendit mbi advokacinë, lobimin dhe parimet e buxhetimit të hapur, duke u bazuar në gjetjet e Open Budget Survey 2015, që evidentonin pozicionin e Shqipërisë në transparencën buxhetore.

Organizatave të trajnuara iu kërkua të analizonin e përgatisnin rekomandime mbi buxhetin e vitit 2016 të Ministrive të Arsimit e Sportit dhe asaj të Çështjeve Sociale dhe Rinisë. Procesi kulmoi me seanca dëgjimore në Komisionin Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik më 7 dhjetor 2015, ku organizata si Milieu kontakt Albania, Save the Children, Eper Center, Fondacioni Down Syndrome Albania dhe YouthAct paraqitën propozime konkrete për rritjen e buxhetit për çështje prioritare si fëmijët, ënjtë dhe mjedisi. Kështu, procesi i buxhetimit qendror u bë objekt i analizës dhe kontributit të shoqërisë civile, por ndikimi i saj u kufizua nga mungesa e zbatimit të plotë të propozimeve.

Sipas Bankës Botërore, buxhetimi me pjesëmarrje ka ndihmuar në rritjen e besimit mes qytetarëve dhe autoriteteve vendore, si dhe në përmirësimin e menaxhimit të buxhetit dhe promovimit të dialogut social. Megjithatë, suksesi ka qenë i kufizuar nga faktorë strukturorë, si varfëria e thellë në disa zona dhe mungesa e burimeve në bashkitë më të vogla.

Disa nënndarje apo strategji alternative për buxhetimin me pjesëmarrje, të cilat janë zbatuar nga aktorët civilë në vendin tonë, po i shqyrtojmë në vijim.

BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR

Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor është një përgjigje ndërsektoriale ndaj pjesëmarrjes së ulët të grave në vendimmarrje dhe një strategji për promovimin e politikave afirmative gjinore, duke ndikuar prioritetet buxhetore. UN Women Albania ka udhëhequr përpjekjet e shoqërisë civile në promovimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor (Gender Responsive Budgeting-GRB) në Shqipëri, duke punuar ngushtë me institucionet qeveritare, aktivistët dhe organizata që operojnë në nivel kombëtar e lokal, për të integruar bazinë gjinore në proceset e planifikimit dhe buxhetimit. Që nga viti 2010, UN Women ka mbështetur Ministrinë e Financave dhe atë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të përfshirë parimet e GRB-së në programet buxhetore afatmesme dhe vjetore.

Kjo iniciativë filloi si një nevojë për të zbatuar politikën e barazisë gjinore të vendosura nga Ligji për Barazinë Gjinore i vitit 2008 dhe u forcua më tej me vendimin e Këshillit të Ministrave në 2012 për përfshirjen e GRB-së në Programin Afatmesëm Buxhetor (MTBP). Në vitin 2016, barazia gjinore u shtua si parim i funksionimit të sistemit buxhetor (neni 4, pika e) dhe GRB u bë një kërkesë ligjore me anë të Ligjit Organik të Buxhetit dhe në 2017 me Ligjin për Financat e Vetëqeverisjes Vendore (neni 36, pika c - të paktën një nga objektivat të adresojë probleme të barazisë gjinore), duke rregulluar zbatimin e saj në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar

publik, përfshirë programimin, monitorimin, raportimin dhe auditimin.

Tentativat për të institucionalizuar GRB-në kanë treguar përparim të dukshëm me kalimin e kohës. Në vitin 2014, vetëm 4 nga 125 programet buxhetore (1% e buxhetit total) i nënshtroheshin qasjes gjinore, ndërsa në vitin 2020, kjo shifër u rrit në 43 nga 75 programe buxhetore (9% e buxhetit të qeverisë qendrore). Përmëtepër, financimi për barazinë gjinore është rritur ndjeshëm, nga 90 milionë USD gjatë periudhës 2017-2019 në mbi 800 milionë USD për periudhën 2025-2027, duke arritur nga 1% në 10% të buxhetit kombëtar. Kjo rritje reflekton integrimin e GRB-së në sektorë kyç si arsimit, shëndetësia, bujqësia dhe drejtësia, duke siguruar që politikën publike të adresojnë nevojat e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë. Gjithashtu, mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë është bërë e detyrueshme (neni 13, pika d), duke mundësuar një analizë më të saktë të nevojave dhe ndikimeve gjinore.

Gjatë viteve UN Women ka mbështetur gjithashtu zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve qendrore dhe lokale për të zbatuar GRB-në. Një shembull konkret është bashkëpunimi vitin e shkuar, 2024, me Parlamentin e Shqipërisë për të forcuar rolin mbikëqyrës në monitorimin e shpenzimeve buxhetore me perspektive gjinore, si dhe për të zhvilluar plane pune për prioritetet e barazisë gjinore. Programi rajonal “Transformative Financing for Gender Equality” (2020-2024), i financuar nga SIDA, ka qenë një nismë kyçe për të integrimin e financimit me bazë gjinore në planet lokale e kombëtare në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë Shqipërinë.

Por, një nga arritjet më të mëdha në këtë aspekt ka qënë krijimi dhe mbështetja për rrjetin PRISMA (Platforma për Integrimin e Perspektivës Gjimore në Menaxhimin e Financave Publike), një rrjet joformal organizitash, aktivistësh e bashkish, që bashkëpunojnë për **përmirësimin e proceseve të buxhetimit** me perspektivë gjimore në nivel lokal në Shqipëri.

RISMA ka publikuar së fundmi raporte monitoruese për buxhetimin e shërbimeve sociale në 5 bashki të vogla, duke ofruar perspektivë mbi sfidat dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e planifikimit buxhetor vendor.

Disa nga sfidat e evidentuara në raporte ishte mungesa apo cilësia e dobët e të dhënave në bashkitë e vogla, që ndikonte në saktësinë e përfundimeve apo zgjidhjeve që propozoheshin; si dhe nevoja për rritje të ndërgjegjësimit të komunitetit mbi shfrytëzimin e shërbimeve dhe burimeve mbështetëse që ndërkohë janë në dispozicion në këto zona.

3.3

PLATFORMAT E HAPURA

Albanian Institute of Science ka transformuar aksesin në të dhënat buxhetore përmes platformave si “Open Spending Albania”, “Open Procurement Albania” dhe “Money and Power” qysh prej themelimit, në vitin 2011, përmes aplikimit të standardeve të të dhënave të hapura e të lidhura. Standardet për të dhënat e hapura nënkuptojnë ndarjen

e të dhënave që janë të dokumentuara, cilësore, të ripërdorshme, në formate të përpunueshme e lehtësisht të aksesueshme. Open Spending gjurmon të gjitha transaksionet e Thesarit dhe ofron informacion të detajuar mbi pagesat ditore të kryera nga administrata shtetërore, duke e bërë më të lehtë identifikimin e shpenzimeve të dyshimta.

Platformat tjerat të ndërlidhura më të parën si OpenCorporates dhe OpenProcurement publikojnë të dhëna të hapura për shpenzimet dhe kontratat publike, duke mundësuar monitorim në kohë reale nga qytetarët, por edhe duke lehtësuar hulumtimin nga gazetarët, akademikët dhe organizatat. AIS gjithashtu kryqëzon të dhënat e platformave për të prodhuar analiza të thelluara (si ajo mbi buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë gjatë pandemisë COVID-19, ku u identifikuan shpenzime të dyshimta prej 12 milionë eurosh për pajisje mjekësore, që nga ana tjetër nxiti hetime nga Kontrolli i Lartë i Shtetit) apo edhe dokumente me rekomandime politikash si “Kontrolli financiar dhe procesi i hapjes së negociatave për Kapitullin 32” dhe Kontrolli Financiar në Shoqëritë në Pronësi Publike.

AIS ka rritur kapacitetet e OSHC-ve, por edhe gazetarëve lokalë për të investiguar shpërndarjen e kontratave publike, duke ndihmuar në identifikimin e shpërndarjes së fondeve sipas klientëve dhe grupeve gjimore. Kjo ka çuar në një bum publikimesh mediatike që përdorin të dhënat e platformës për të nxjerrë në pah abuzimet, një trendi të cilit i është bashkuar edhe Prokuroria e Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe

Korrupsionit së fundmi. Sporadikisht, organizata është përballur me kufizime financiare për mbajtjen dhe mirëmbajtjen e këtyre platformave vitet e fundit, refuzimin e institucioneve për të ofruar të dhëna të plota, nevojën për më shumë ndërgjegjësim qytetar për përdorimin e platformave dhe mungesën e vullnetit për adoptimin e rekomandimeve të politikave.

3.4

DËGJESAT PUBLIKE

Organizatateshoqërisë civilejanëpërpjekur tëlehtësojnëndërviteorganiziminedëgjesave publike për të rritur përfshirjen qytetare në ciklin buxhetor. Në kuadër të projektit “Për një qeverisje lokale transparente” (2018-2020), Europartners zhvilloi 25 dëgjesa në 10 bashki, duke angazhuar mbi 500 qytetarë. Në Vlorë, në 2019, qytetarët propozuan rritjen e fondeve për mirëmbajtjen e shkollave, propozim që u përfshi në buxhetin e 2020. Qendra Kombëtare Burimore ka zhvilluar fushata si “Buxheti ynë, zëri ynë” në 2021, duke angazhuar mbi 200 banorë ruralë në Korçë dhe Elbasan për të diskutuar prioritetet buxhetore (Qendra Kombëtare Burimore, 2021).

Organizimi i të tilla dëgjesave ka hasur jo rrallë herë në vështirësi, sicc dëshmojnë edhe organizatat Down Syndrome Albania dhe Instituti për Ndryshim dhe Leadership, të cilat si pjesë të monitorimeve të realizuara në kuadër të BAT (që do ta trajtojmë më gjerësisht në vijim), morën përsipër dhe lehtësimin

e dëgjesave mbi buxhetin mes grupeve të shënjestruara dhe institucioneve lokale.

Megjithatë, sicc e trajtuam edhe më siëpr, mundësitë e OSHC-ve për të angazhuar komunitetet e tyre.

Në fakt, nisma e Down Syndrome Albania për të angazhuar prindër dhe persona me aftësi të kufizuara në diskutimet e Këshillit Bashkiak Tiranë mbi buxhetin e vitit 2024 ngeli e porealizuar për shkak të mungesës së njoftimeve, pavarësisht shprehjes së interesit pranë bashkisë. E njëjta pengesë u shfaq në konsultimet mbi Planin Social 2025-2027 dhe Planin Lokal Social për Persona me Aftësi të kufizuara, ku njoftimi erdhi ditën para se konsultimi të mbahej dhe pati ndryshim të vendit në momentin e fundit. Kjo bëri që pjesëmarrës në këtë të fundit të ishin vetëm organizata të shoqërisë civile, por jo pjestarë të komunitetit.

Këto eksperiencia reflektojnë përpjekjet e shoqërisë civile për të ndërtuar një dialog mes institucioneve dhe qytetarëve, ndërkohë që vetë OSHC-të përballen me pamundësinë për t’u angazhuar në konsultime publike. Një raport i Qendrës Burimore Kombëtare gjeti që vetëm 40% e OSHC-ve ishin përfshirë në procese konsultimi, një hap pas në krahasim më vitet e mëparshme.

Ndërkohë, qytetet europiane po zbatojnë skema e mekanizma inovatorë që synojnë përfshirjen dhe angazhimin në konsultime të sa më shumë qytetarëve dhe komuniteteve të marginalizuara.

Në Agen të Francës konsultimet mbi projektet publike mbahen në 2 sheshet kryesore, shumë më parë se të merret vendimi mbi planet konkrete.

Për projektet infrastrukturore, qytete si Santa Maria da Feira në Portugali dhe Dinslaken në Danimarkë po aplikojnë “shëtitjet safari”, që përfshijnë inspektimin e terrenit nga qytetarët para se ata të vendosin se çfarë duan të bëjnë me hapsira të caktuara.

Sa më sipër nxjerr në pah edhe më shumë nevojën për një ligj të ri të konsultimeve, që të përcaktojë role e përgjegjësi të qarta, njoftim e konsultime me afate përshtatshme e të detyrueshme, të nxisë pjesëmarrjen duke e ccliruar nga kontrolli institucional, të prezantojë procedura ankimi dhe të përcaktojë masa në rast moszbatimi nga autoritetet që zhvillojnë konsultimin.

3.4

MONITORIMI I BUXHETEVE TË TARGETUARA

Buxhetimi i targetuar ka potencialin të bashkojë komunitetet e lidhur gjeografikisht e që fizikisht mund të ndërveprojnë pak, por që i bashkojnë sfidat. Është një strategji që mund të jetë përgjigja për problemet që prekin grupet më të cënueshme në shoqëri dhe për përfshirjen e zërit të tyre në vendimmarrjet e niveleve të ndryshme.

Qendra Kombëtare Burimore ka zbatuar projektin “Monitorimi i institucioneve vendore dhe bashkëhartimi i politikave publike” në vitin 2021, që angazhoi komunitetet në Elbasan dhe Korçë për të ndikuar në alokimin e buxheteve për shërbimet sociale, duke rezultuar në rritjen e fondeve për qendrat komunitare në këto bashki.

Fondacioni Down Syndrome Albania (DSA) ka qenë aktiv në monitorimin dhe vlerësimin financiar të programeve për personat me aftësi të kufizuara, duke u fokusuar në transparencën dhe efektivitetin e shpenzimeve publike. Në vitin 2023, DSA publikoi raportin e parë të monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2021-2025), duke analizuar alokimin dhe zbatimin e buxhetit për shërbimet sociale dhe arsimin gjithëpërfshirës. Raporti zbuloi se vetëm 70,000 nga 140,000 persona me aftësi të kufizuara në Shqipëri përfitojnë ndihmë financiare, dhe buxheti afatmesëm 2021-2023 kishte ulur fondet për punësimin e kësaj kategorie. DSA gjithashtu kritikoi mungesën e mbështetjes financiare për familjarët kujdestarë dhe heqjen e pagesave për fëmijët me diabet tip 1, duke theksuar pasojat në shëndetin e tyre.

Në një rast tjetër DSA-ja ka monitoruar dhe zhvilluar analizën financiare të Shërbimeve Sociale në Bashkinë Tiranë (për vitin 2022), duke zbuluar se vetëm 2,248 nga 55,237 persona me aftësi të kufizuara në Tiranë përfituan shërbime nga qendrat publike sociale. Kjo e gjetje të tjera u përdorën për të advokuar për rritjen e fondeve për qendrat komunitare dhe trajnimin e 130 profesionistëve të arsimit për gjithëpërfshirjen sociale. Sfidat përfshijnë mungesën e të dhënave të detajuara nga bashkia dhe rezistenca për të zbatuar rekomandimet.

DSA ka kontribuar gjithashtu përmes projekteve si “Together we Grow Stronger” (2022), i bashkëfinancuar nga BE dhe World Vision Albania, i cili monitoroi buxhetin

për arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me sindromën Down. Projekti rezultoi në publikimin e një udhëzuesi për ndërhyrjen e hershme dhe trajnoi 60 studentë të shkencave sociale për shërbimet të ardhshme për personat me aftësi të kufizuara (DSA, 2022). Këto përpjekje e të tjera të ngjashme kanë rritur presionin për transparencë, por përballen me mungesë bashkëpunimi institucional dhe mosvazhdimësi për shkak të financimit të pamjaftueshëm apo përpjekjeve ad hoc me baza projektesh.

3.4

FUQIZIMI I MË SHUMË AKTORËVE CIVILË DHE ORGANEVE TË PAVARURA

Programi **BAT** (Mbikëqyrja Civile e Llogaridhënies dhe Transparencës Buxhetore) i zbatuar nga Institute for Democracy and Mediation (IDM), Faktoje dhe Center for Research and Policy Making (CRPM) në Shqipëri ka për qëllim forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes publike në proceset buxhetore. Në fazën e parë (2015-2020), programi u fokusua në rritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar dhe raportuar mbi shpenzimet publike, duke promovuar qeverisje të hapur dhe luftën ndaj korrupsionit. Qasja përfshinte trajnime, analiza të politikave buxhetore dhe nisma për ndërgjegjësim publik, duke synuar ndikimin në politikat fiskale dhe përmirësimin e qeverisjes lokale.

Në fazën e dytë (2023-2025), programi BAT u zgjerua me nisma si BAT Monitor dhe BAT Expose, të cilat i hapën rrugën fuqizimit të aktorëve të tjerë civil si gazetarët, akademikët dhe institucionet e pavarura si Komisioneri i së Drejtës për Informim dhe KLSH-ja. Projekti ndoqi një qasje të shtresëzuar, që e adreson problemin në dy nivele.

1. Në planin civil, duke fuqizuar OSHC-të që të marrin pjesë në mënyrë efektive në planifikimin dhe monitorimin e zbatimit të buxhetit, përmes:

- një cikli trajnimesh mbi transparencën dhe llogaridhënien e buxhetit, prokurimin publik, buxhetimin gjinor dhe mjetet e monitorimit e vlerësimit të buxhetit;
- mbështetjes, me anë të Skemës së Nëngrantimeve BAT, të rreth 35 iniciativave të shoqërisë civile, akademisë dhe medias, për të vlerësuar dhe promovuar pjesëmarrjen publike dhe për të prodhuar vlerësime të buxhetit bazuar në të dhëna.

2. Në nivel politikash, duke shfrytëzuar hulumtimet e mësipërme e përvojën e shoqërisë civile për të ndikuar në përmirësimin e kuadrit ligjor e praktikave institucionale mbi planifikimin, zbatimin dhe raportimin e buxhetit, si dhe duke forcuar mekanizmat e mbikëqyrjes publike, përmes mbështetjes për Komisionerin e të Drejtës e Informimit dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Raportet e mbështetura nga programi BAT kanë evidentuar një sërë problemesh, të tilla si:

- mungesa e një metodologjie kapilare për mbledhjen, raportimin e përpunimin e të dhënave kufizon aftësitë planifikuese të njësive të vetqeverisjes lokale;
- shumica e bashkive kanë një varësi të madhe nga transfertat e buxhetit qendror, të cilat variojnë nga 20-44%;
- shumica e investimeve nga autoritetet lokale janë infrastrukturore dhe ato mbeten të kufizuara;
- planeve të buxhetit iu mungojnë indikatorët e matshëm, ndërsa raportet e monitorimit nga institucionet janë formale dhe raportimi mbi përmbushjen e objektivave është sipërfaqësor, ndërkohë që nuk ndjekin një format të unifikuar raportimi që të lehtësojë krahasimet dhe vlerësimin e performancës;
- shumë bashki nuk kanë krijuar struktura ose mekanizmatë qendrueshëm për të siguruar gjithëpërfshirje;
- për konsultimet publike bëhen përpjekje minimale apo me raste, fare formale, njoftimet për mbajtjen e tyre janë shpërndarë në mënyrë të pjesshme ose me vonesë, duke reduktuar mundësinë e përfshirjes së qytetarëve;
- planet e buxhetit nuk diferencojnë mes kategorive të ndryshme të grupeve të cënueshme, duke pamundësuar ofrimin e zgjidhjeve specifike për këto grupe, dhe duke kufizuar suksesin e masave të planeve lokale sociale dedikuar këtyre kategorive.

- mungesa e koordinimit institucional dhe mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare kufizojnë potencialin për të realizuar planet vendore e strategjitë ndërsektoriale apo ofruar shërbime të specializuara.
- mungesa e kapaciteteve dhe ekspertizës pengon diversifikimin e burimeve financiare e projekteve të njësive lokale, dy faktorë që janë identifikuar më me bollëk mes shoqërisë civile.

Këtyre konstatimeve, iu shtohen edhe sfidat me të cilat përballen organizatat e shoqërisë civile që zbatojnë këto projekte.

IV. Mësime të nxjerra nga përpjekjet e shoqërisë civile

Nga praktikat e ndara më sipër, provohet se shoqëria civile është përpjekur të kompensojë pamundësinë për një ndjekje sistematike të problemit, përmes një qasjeje nga disa kënde e disa nivele njëkohësisht. Megjithatë suksesi i këtyre përpjekjeve nuk do të mund të kuptohet, nëse ai nuk kryqëzohet me situatën dhe ekosistemin në të cilin vetë organizatat operojnë. Kuptimi dhe adresimi i këtyre faktorëve kushtëzues, mund të prodhojë mësime të çmuara mbi rrugën që duhet ndjekur në të ardhmen për fuqizimin e demokracisë pjesëmarrëse përmes advokimit buxhetor.

4.1

KUFIZIMET FINANCIARE DHE STRUKTURORE PENGOJNË QËNDRUESHMËRINË

Raportet mbi vështirësitë me të cilat përballen OSHC-të tregojnë se mungesa e financimeve të qëndrueshme dhe e kapaciteteve teknike kufizon vazhdimësinë e projekteve. Shumë OSHC varen nga donatorë ndërkombëtarë e prioritetet e tyre politike e strategjike dhe përfundimi i projektit shpesh do të thotë mbyllje e fushatës advokuese. Njëri nga shembujt që përmendëm ishte ai i platformave Open Data Albania, që kanë

pasur një sukses të paprecedentë në sigurimn e aksesit në të dhëna, me mbi 30,000 vizitorë unikë në 2020 (AIS, 2021). Megjithatë, kjo nuk ka mjaftuar për ta mbrojtur nga paqendrueshmëria financiare, me organizatën që u detyrua të ngre alarmin se mungesa e fondeve porrezikonte mbylljen e platformave vitin e shkuar. Po ashtu, raportet mbi vështirësitë e OSHC-ve tregojnë se 60% e tyre përballen me refuzime për të siguruar të dhëna nga institucionet (Civil Society Index Albania, 2020).

Ky mësim nënvizon nevojën për modele financimi afatgjatë dhe për trajnime që adresojnë jo vetëm aftësitë teknike, por edhe menaxhimin financiar të organizatave.

4.2

BUXHETIMI ME PJESËMARRJE MUND TË JETË EFEKTIV, POR VARET NGA ANGAZHIMI INSTITUCIONAL

Projektet e buxhetimit me pjesëmarrje kanë treguar potencialin për të ndikuar në alokimet buxhetore, megjithatë, raportet mbi angazhimin e publikut në procese të tjera vendimmarrëse tregojnë se dëgjesat publike shpesh janë formale dhe nuk reflektojnë propozimet për mungesë vullneti politik (OSF, 2021). Përpjekjet institucionale për përfshirjen qytetare, si konsultimet e

bashkive, janë të pamjaftueshme, me vetëm 15% të qytetarëve që ndihen të përfshirë (BIRN Albania, 2022). Këto fakte sugjerojnë nevojën për mekanizma detyrues për zbatimin e propozimeve qytetare dhe për presion ndaj institucioneve për të organizuar procese të vërteta pjesëmarrjeje. Një mënyrë për të ndikuar do të ishte që monitorimet e zbatimit të buxheteve, të shoqërohen nga monitorimi hap pas hapi të procesit të konsultimeve. Ndoshta është me vend që të hartohet një metodologji më e plotë për organizimin e proceseve të konsultimeve dhe dëgjësive publike, që të jetë e detyrueshme për tu zbatuar nga organet e pushtetit vendor. Në këtë kontekst, si partner mund të shërbjenë këshillat bashkiak të cilat janë pluraliste dhe mund të përfshijnë vetë anëtarët e këshillave bashkiak në këto procese.

4.3

MONITORIMI I BUXHETEVE TË TARGETUARA NXJERR NË PAH PABARAZI, POR KËRKOJNË BASHKËPUNIM INSTITUCIONAL

Monitorimet e buxheteve të targetuara (për shërbimet sociale, për buxhetimin gjinor, për pakicat Rome e Egjyptiane etj.) kanë zbuluar mungesë prioritësh për shërbimet sociale në tërësi e shtresat në nevojë dhe grupet e cënueshme në veçanti. Shërbimet sociale lokale kufizohen në masë me menaxhimin e pagesave direkte nga buxheti qendror dhe sigurimin e funksionimit të qendrave sociale në varësi. Këto të fundit vuajnë nga mungesa e burimeve njerëzore, ekspertizës për thithjen

e projekteve, mungesa e kapaciteteve, shërbime të kufizuara e të mbivendosura për një sërë kategorish dhe nga mungesa e investimeve.

Gjetjet e këtyre raporteve - për shkak se bazohen në të dhëna konkrete - janë shumë të vlefshme për advokim, por mungesa e bashkëpunimit institucional kufizon ndikimin mundshëm. Nga ana tjetër, Indeksi i Shoqërisë Civile në Shqipëri i botuar nga IDM Albania, tregoi se efektiviteti i fushatave të shoqërisë civile është më i madh në rastet kur janë shënjestruar politika specifike, jo parime të përgjithshme të qeverisjes së mirë. Njëkohësisht, i njëjti studim ka dalë në përfundimin se një nga pikat e forta të shoqërisë civile në vend është ekspertiza e bazuar në të dhëna.

Këto tregues bashkarisht sugjerojnë se aksionet e ardhme të shoqërisë civile duhet të ngulmojnë në vlerësimin e performancës së buxheteve të targetuara, me qëllim prodhimin e propozimeve të politikave e masave ndërhyrëse konkrete. Aksione të tilla kanë dobishmëri të dyfishtë, pasi prodhojnë gjurmë dokumentare që mund të rimerret e të ripërdoret si pikë reference nga donatorët, OSHC-të, akademikët dhe vendimmarrësit në të ardhmen.

4.4

ANGAZHIMI I ULËT QYTETAR REFLEKTON MUNGESËN E BESIMIT NË SHOQËRINË CIVILE

Besueshmëria e ulët e qytetarëve ndaj institucioneve është një fenomen i

mirëdokumentuar ndër vite në vend, me 70% të qytetarëve që në vitin 2022 i konsideronin institucionet si jo transparente. Një sondazh tjetër i zhvilluar nga IDM në lidhje me transparenën dhe llogaridhënien tregoi se më shumë se gjysma e qytetarëve të anketuar (59% për qeverinë qendrore dhe 60.2% për qeverisjen vendore) mendojnë se të dy nivelet e qeverisjes kanë mungesë transparence. Raportet mbi angazhimin e publikut në procese të tjera, si konsultimet për planet urbanistike, tregojnë se vetëm 10% e qytetarëve ndihen të përfshirë.

Ky perceptim justifikon pjesërisht edhe indiferencën e publikut të gjerë për t'u përfshirë në procese të llogaridhënjes buxhetore mes të tjerash. Por këto shifra në vetvete janë të pamjaftueshme për të mbështetur prirjen e angazhimit të ulët qytetar. Ky trend shpjegohet vetëm nëse mungesës së besimit ndaj institucioneve i bashkëngjitet edhe mungesa e besimit të shoqëria civile dhe perceptimi se organizatat e shoqërisë civile ndjekin interesat e tyre të ngushta. Fakti është se shoqëria civile nuk ka mundur të hedh "rrënjë" në komunitetet të cilat simbolikisht përfaqëson. Në fakt, shumica e "pjesëmarrësve" në projektet që kemi përmendur edhe më sipër janë ndërkohë anëtarë aktiv në shoqëri.

Shoqëria civile ka nevojë të orientohet drejt projekteve komunitare e lëvizjeve grassroots dhe me ndërgjegje, të investohet në krijimin dhe kultivimin e raporteve me komunitetet respektive dhe të ndërtojë strategji për angazhimin qytetar që përfshijnë fushata në media sociale e ndarje të materialeve informuese të thjeshtuara mbi buxhetimin me pjesëmarrje.

4.5

REZISTENCA INSTITUCIONALE PENGON NDIKIMIN E SHOQËRISË CIVILE

Raportet mbi përpjekjet institucionale për përfshirjen qytetare tregojnë se konsultimet shpesh organizohen për të përmbushur formalitete ligjore, pa ndikim real në vendimmarrje (BIRN Albania, 2022; Komiteti I Helsinkit 2023). Ky mësim sugjeron nevojën për presion të koordinuar nga OSHC-të dhe donatorët ndërkombëtarë për të detyruar institucionet të bashkëpunojnë, si dhe për krijimin e mekanizmave ligjorë që sanksionojnë moszbatimin e transparencës.

4.6

KOORDINIMI MES OSHC-VE RRIT EFEKTIVITETIN E NISMAVE

Raportet mbi vështirësitë e OSHC-ve tregojnë se mungesa e një rrjeti të koordinuar organizatash kufizon aftësinë për të ndikuar në politika kombëtare (Civil Society Index Albania, 2020). Nga ana tjetër, sukseset e organizatave si UN Women Albania me Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinnor kanë faktuar ndikimin që rrjetet e tilla kanë në vendimmarrje, në mos edhe përpjekjen për t'ju bashkangjitur fushatave ndërkombëtare apo rajonale të së njëjtës tematikë. Kjo nënvizon nevojën për një **platformë kombëtare të OSHC-ve** mbi transparencën e llogaridhënien buxhetore, që të bashkërendojnë përpjekjet, të ndajnë burimet e praktikat më të mira dhe të ndërtojnë fushata advokimi të ngritura mbi suksese të mëparshme.

***NXITJA E STANDARDEVE
TË TRANSPARENCËS NGA BE-JA
FAVORIZON PRESIONIN NDAJ
INSTITUCIONEVE***

Plani i Rritjes i BE-së favorizon integrimin e shoqërisë civile në përpjekjet për transparencë dhe llogaridhënie buxhetore duke ofruar mbështetje financiare dhe teknike për rritjen e kapaciteteve të organizatave lokale. Ai promovon standarde të larta për publikimin e të dhënave buxhetore në kohë dhe formate të aksesueshme, duke mundësuar monitorimin efektiv të shpenzimeve publike. Përmes trajnimeve, platformave digjitale dhe projekteve për buxhetim me pjesëmarrje, shoqëria civile forcohet për të advokuar për qeverisje të mirë dhe për të nxitur përfshirjen qytetare në proceset buxhetore.

V. Rekomandime për një advokim buxhetor më efektiv

Këto rekomandime adresojnë sfidat kryesore me të cilat përballet shoqëria civile në përpjekjet për transparencë e llogaridhënie buxhetore, si mungesa e financimit, besueshmëria e ulët ndaj institucioneve, angazhimi i ulët qytetar dhe rezistenca institucionale, duke ofruar strategji të përshtatura për secilin aktor për të fuqizuar advokimin buxhetor dhe transparencën në Shqipëri.

5.1

REKOMANDIME PËR SHOQËRINË CIVILE

Transparenca dhe kërkesa e llogarisë fillojnë nga vetja: OSHC-të dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) duhet të publikojnë raporte vjetore të detajuara mbi financimin e projekteve dhe shpërndarjen e fondeve. Kjo do t'u jap atyre autoritet në dialogun me aktorët institucional dhe besueshmëri në publik.

Komuniteti është çelësi i buxhetimit me pjesëmarrje: Shoqëria civile duhet të gjej e kultivojë lidhje me komunitetet, duke rekrutuar e mbështetur udhëheqës a persona me autoritet në komunitet apo duke inkurajuar e mbështetur lëvizje grassroots.

Një faktor potencial dhe aleat i OSHC janë anëtarët e këshillave bashkiake të cilët janë zgjedhur nga vetë komunitetet por që shpesh e gjejnë të pamundur të ushtrojnë pushtetin e tyre për shkak të mosfunksionimit siç duhet të vetë këshillit.

Të dhënat e hapura janë arma kundër mbylljes e refuzimit institucional: Suksesi i platformave Open Data të Albanian Institute of Science sugjerojnë që rruga për transparencën dhe llogaridhënien buxhetore duhet të bazohet në të dhënat e aksesueshme, të lehta për t'u përpunuar e për t'u lexuar nga publiku. Shoqëria civile duhet të investojë e të advokojë për të dhënat e hapura, që duhet të shoqërohen me fushata për të arritur në një audiencë të gjerë dhe me strategji për të thjeshtuar të dhënat për audiencë më të gjera, përfshirë grupet e marginalizuara.

Rrjetëzimi është përgjigja ndaj kufizimeve financiare: Shoqëria civile duhet të krijojë një koalicion kombëtar për të ndarë praktikat më të mira, për të dalë me një agjendë të përbashkët, për t'u koordinuar për fushata advokimi dhe për të ndarë burimet në lidhje me financimin e projekteve mbi transparencën e llogaridhënien buxhetore. Pjesë e tij duhet të jenë edhe partnerë civilë si media investigative, akademikë të fushës dhe institucionet e pavarura mbikqyrëse.

REKOMANDIME PËR QEVERINË

Instrumentalizimi i ekspertizës në ndërtimin e dialogut me institucionet: Organizatat e shoqërisë civile mund të ndihmojnë me ekspertizë e ngritje kapacitetesh për të rritur aftësitë e qeverive lokale në përthithjen e fondeve nga burime alternative si donatorët ndërkombëtarë apo BE-ja. Në fakt, me avancimin e procesit të integritetit, kjo ekspertizë do të jetë gjithmonë e më e lakmuar nga qeveria, për shkak të kriterëve të transparencës dhe standardeve në menaxhimin e fondeve të BE.

Monitorimi i buxheteve të targetura si strategji advokimi: Organizatat duhet të vijojnë me monitorimet e targetuara për sektorë specifikë, që shërbejnë si bazë për të evidentuar e adresuar probleme specifike. Kjo strategji favorizohet nga zgjerimi që ka marr publikimi i strategjive e planeve lokale të veprimit në shumë bashki, duke hapur një mundësi për angazhim të OSHC-ve në aksione monitorimi të planeve financiare të parashikuara për përmbushjen e objektivave të tyre.

Përfshirja dhe kontributi në procesin e integritetit: Shoqëria civile ka një mundësi të artë në Planin e Rritjes që nga njëra anë të ndikojë në strategjitë e BE-së për mbështetjen e shoqërisë civile dhe nga ana tjetër të zhvillojë kapacitetet e veta dhe të kërkojë financim për projektet e propozuara më sipër (projekte komunitare, projekte monitorimi etj.), që nxisin përmbushjen e kriterëve të transparencës e llogaridhënies buxhetore dhe gjithëpërfshirjen.

Krijimi i mekanizmave formalë për buxhetimin me pjesëmarrje: Qeveria duhet të krijojë një kalendar kombëtar për dëgjesa publike, duke detyruar bashkitë të konsultohen me qytetarët dhe OSHC-të, siç propozohet nga Open Government Partnership (OGP, 2020). Këto konsultime duhet të jenë transparente dhe të dokumentohen publikisht.

Publikimi i të dhënave buxhetore në formate të hapura dhe të përditësuara: Qeveria, përmes Ministrisë së Financave dhe bashkive, duhet të publikojë të dhëna buxhetore në kohë reale dhe në formate të hapura, siç praktikohet në Afrikën e Jugut. Njëkohësisht, ajo mund të krijojë një faqe web qendrore për mbledhjen dhe ndarjen e të dhënave makroekonomike e financiare, si fqinji jonë, Serbia, e cila ka integruar sistemin GDDS (General Data Dissemination System) të FMN-së në faqjen e Zyrës së Statistikave të Republikës së Serbisë. Publikimi të dhënave të tilla në një ndërfaqe, lehtëson aksesin dhe analizën e performancës financiare nga të gjitha palët e interesuara.

Përmirësimi i zbatimit të kuadrit ligjor për transparencë: Ligji për të Drejtën e Informimit është premtues, por zbatimi i dobët kufizon efektivitetin e tij. Qeveria duhet të vendosë sanksione për institucionet që refuzojnë të ofrojnë informacion publik dhe të trajtojë dhe inkurajoj zyrtarët që t'iu

përgjigjur kërkesave të OSHC-ve dhe qytetarëve. Gjithashtu, me ndihmën e shoqërisë civile, të hartohet një metodologji e re dhe e plotë e organizimit të procesit të dëgjësive dhe konsultimeve publike, që të jetë e detyrueshme si për organet qendrore dhe ato lokale të pushtetit.

Riformatimi i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile: Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile duhet të riformatohet për të pasur mundësi reale ndikimi në vendimmarrje, duke mandatuar takime të rregullta mes Këshillit dhe ministrive, ku pjesëmarrja e titullarit të Ministrive është e detyrueshme. Kjo qasje ka funksionuar në Poloni, ku platforma e dialogut qytetar ka rritur ndikimin e OShC-ve në politikat publike.

5.3

REKOMANDIME PËR INSTITUCIONET E PAVARURA

Forcimi i monitorimit të shpenzimeve publike: KLSH duhet të publikojë raportet e auditimit në kohë reale dhe të bashkëpunojë me OSHC-të për të shpërndarë gjetjet. Për më tepër, KLSH mund të zhvillojë raporte të thjeshtuara për publikun, duke ndjekur modelin e Social Justice Ireland (SJI). Vetë KLSH duhet të jetë më transparente dhe të investojë në sisteme inteligjente për të rritur cilësinë e punës së saj dhe shmangur politizimin e gjetjeve të raporteve të auditimit.

Krijimi i mekanizmave të bashkëpunimit me OSHC-të: KLSH dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit duhet të krijojnë tryeza të përbashkëta pune me OSHC-të për të diskutuar gjetjet e monitorimeve dhe për të adresuar refuzimet për informacion. Kjo qasje, e praktikuar nga institucionet në Serbi, mund të rrisë bashkëpunimin dhe transparencën. Një alternativë do të ishte edhe krijimi i marrëveshjeve mes palëve për të mundësuar auditimin me pjesëmarrje, një metodë pak e eksploruar në Shqipëri, që lejon qytetarët të marrin pjesë në mbikqyrjen e financave publike. Në këtë rast OSHC-të shërbejnë jo vetëm për të aktivizuar qytetarët, por ato ofrojnë informacion të dobishëm, të kualifikuar dhe të bazuar në fakte në lidhje me cilësinë e shërbimeve të ofruara nga agjencitë shtetërore.

Advokimi për politika të bazuara në të dhëna: Institucionet e pavarura mund të përdorin gjetjet e OSHC-ve, si raportet e DSA-së për personat me aftësi të kufizuara, për të rekomanduar politika më përfshirëse. KLSH mund të shërbejë si urë lidhëse mes organizatave dhe Parlamentit, duke përdorur këto të dhëna për të rekomanduar ndryshime ligjore dhe buxhetore, siç ka bërë Auditor General në Malavi me mbështetjen e OSHC-ve .

REKOMANDIME PËR DONATORËT NDËRKOMBËTARË

Sigurimi i financimeve afatgjata për OSHC-të: Donatorët duhet të ofrojnë financime afatgjata për OSHC-të, të cilat mund të kushtëzohen me nivelin e përfshirjes së komuniteteve nga ana e organizatave. Ky hap mund të hidhet ndërsa paralelisht mund të mbështesin rrjetëzimin e OSHC-ve dhe ngritjen e kapaciteteve, aty ku ka nevojë.

Kushtëzimi i financimeve me përmirësime në transparencë: Donatorët duhet t'i lidhin financimet e projektuara në favor të qeverisë qendrore dhe bashkive me përmirësime në treguesit e transparencës, si publikimi i të dhënave të hapura dhe organizimi i dëgjësive të njëmëndëta publike. Një tjetër qasje mund të ishte përdorimi i incentivave ndaj atyre institucioneve që bëjnë progres në ato drejtime. Qasje të tilla mund të bashkërendohen dhe amplifikohen nga monitorimet e OSHC-ve për të rritur nivelin e llogaridhënjes.

Riorientimi drejt projekteve komunitare: Donatorët duhet të zhvendosin fokusin nga projekte të mëdha të drejtuara nga lart-poshtë në iniciativa të vogla, të orientuara nga nevojat lokale.

BIBLIOGRAFIA

1. Ligji nr. 9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
2. Ligji Nr. 119/2014 Për të Drejtën e Informimit. (2014). Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 137.
3. Ligji Nr. 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. (2014). Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 178.
4. Vurmo, G. (2021). Ruajtja e Rojtarëve: Mbikëqyrja Parlamentare e Institucioneve të Pavarura në Shqipëri. Institute for Democracy and Mediation (IDM).
5. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri. (2024). Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të OSHC-ve në Shqipëri.
6. Qendra Res Publica. (2019). Konsultimi publik 2017-2018. Tiranë.
7. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (2024). Zmbrapsja demokratike dhe tkurrja e hapësirës qytetare. Tiranë. Ministria e Financave, 2023. Strategjia Sektoriale për Menaxhimin e Financave Publike 2023-2030
8. International Budget Partnership (IBP). (2023). Open Budget Survey: Albania.
9. Local Government Association. (2016, December 12). Case study: Porto Alegre, Brazil.
10. Rebeça Abers, Robin King, Daniely Votto and Igor Brandão, 2018, World Resources Institute,
11. Urban Research Institute. (n.d.). Participatory budgeting in Albania.
12. World Bank. (n.d.). Participatory budgeting.
13. Urban Research Institute. (2015). Indeksi i transparencës për buxhetin 2008 dhe 2009.
14. World Bank. (2006). Participatory Budgeting Toolkit for Local Governments in Albania. Washington, DC: World Bank.
15. World Bank. (2010, April 23). World Bank supports empowerment of the marginalized and vulnerable groups in the development processes in Albania.
16. Urban Research Institute. (2018). Mbështetja e 7 bashkive në hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, PBA, Instrumentit të Planifikimit Financiar (FPT), Paketës Fiskale dhe Buxhetit Vjetor.
17. Urban Research Institute. (2017). Studim krahasues: Menaxhimi i buxhetit dhe kapaciteti fiskal - Komunitat nga Rajoni i Korçës.
18. Urban Research Institute. (2015). Lobing për rritjen e fondeve për sektorin e bujqësisë nga buxheti.
19. Partners Albania. (2015). Buxhetimi me pjesëmarrje në nivel qendror: Raport përmbledhës. Tiranë: Partners Albania.
20. World Bank. (2012, September 10). Participatory budgeting: An experience in good governance.

21. UN Women. (2023, November). Advancing gender-responsive budgeting in Albania.
22. Fletorja Zyrtare, Ligji 9936/2008 “Për menazhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjin n.57/2016
23. Fletorja Zyrtare, Ligji 68/2017 “Ligjin për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
24. UN Women. (2023, November). Advancing gender-responsive budgeting in Albania.
25. Fletorja Zyrtare, Ligji 9970/2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”
26. UN Women. (2023). Angazhimi i parlamentit në buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.
27. UN Women. (2024). Transformative results.
28. UN WOMEN ALBANIA STRATEGIC NOTE 2022-2026, 2022.
29. UNWomen.(2024,June). Watchdogreports: Gender-responsive budgeting implementation.
30. AIS/Open Data Albania. (2020). Analiza e kontratave të prokurimit gjatë pandemisë COVID-19. Tiranë: AIS.
31. AIS/Open Data Albania. (2021). Raporti vjetor i aktiviteteve 2020. Tiranë: AIS.
32. Albanian Institute of Science. (2022). Kontrolli financiar dhe procesi i hapjes së negociatave për Kapitullin 32.
33. AIS/Open Data Albania. (2023). Trajnimet për Monitorimin Buxhetor.
34. Albanian Institute of Science. (2024). Forcimi i kulturës së monitorimit: Trajnim mbi monitorimin e shpenzimeve dhe kontraktive publike në qeverisjen vendore - Has.
35. AIS/Open Data Albania. (2024). Projektet anti-korrupsion në mungesë fondesh dhe donatori. Tirane:AIS. 2024.
36. Europartners. (2020). Për një qeverisje lokale transparente: Raport përfundimtar. Tiranë: Europartners.
37. Qendra Kombëtare Burimore. (2021). Fushata “Buxheti ynë, zëri ynë”. Tiranë: Qendra Kombëtare Burimore.
38. Down Syndrome Albania. (2023). Raporti i monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025. Tiranë: DSA.
39. Down Syndrome Albania. (2022). Raporti i monitorimit të shërbimeve sociale në Bashkinë Tiranë. Tiranë: DSA.
40. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). (2019). Monitorimi i buxheteve lokale: Gjetje dhe rekomandime. Tiranë: IDM.
41. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). (2020). Raporti i progresit të programit BAT. Tiranë: IDM.
42. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). (2019). BAT Civil Society - Civic Oversight Capacities for Budget Accountability and Transparency. Tiranë: IDM.
43. Qendra për Demokraci dhe Zhvillim (QDA). (2023). Analiza e buxhetit të Bashkisë Durrës: PBA 2024-2026.

44. Zhebo, E., Kaleshi, E., & Zika, R. (2025). Rritja e llogaridhënies dhe transparencës buxhetore në planet vendore të veprimit për energjinë dhe klimën. Instituti për Ndryshim dhe Leadership në Shqipëri
45. Lëvizja Rinore për të Drejtat e Romëve dhe Egjiptianëve (LRER). (n.d.). Sfidat e punësimit dhe vlerësimi i dokumenteve strategjike: Analiza e PBA 2025-2027 për çështjet e punësimit, me fokus kryesor te komunitetet Rome dhe Egjiptiane.
46. Caushaj, R. (2025). Buxheti i Bashkisë Tiranë për personat me aftësi të kufizuara 2024. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.
47. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri. (2024). Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të OSHC-ve në Shqipëri.
48. Albanian Helsinki Committee. (2024). Contribution and challenges of civil society in Albania.
49. Civil Society Index Albania. (2020). Raporti mbi gjendjen e shoqërisë civile në Shqipëri. Tiranë: IDMC
50. Ndiq Paratë. (n.d.). Pjesëmarrje në vendimmarrje për buxhetin në nivel vendor. Albanian Institute of Science(AIS).
51. Qendra Kombëtare Burimore. (2023). Raport mbi Financimin e OShC-ve.
52. UNDP. (2023). Opinion poll 2023 - Albania.
53. IDM Albania. (2014). Civil society and the EU açession process.
54. CIVICUS. (n.d.). Civil society index: Albania.
55. BIRN Albania. (2022). Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrjen lokale. Tiranë: BIRN.
56. European Commission. (2023). EU Growth Plan for the Western Balkans.
57. Open Government Partnership (OGP). (2020). Albania Action Plan Review 2020-2022.
58. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (2021). E drejta për informim.
59. Down Syndrome Albania. (2022). Raporti i monitorimit të shërbimeve sociale në Bashkinë Tiranë. Tiranë: DSA.

Fusnota

1. Ministria e Financave, 2023. Strategjia Sektoriale për Menaxhimin e Financave Publike 2023-2030. E disponueshme: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Strategjia-e-Menaxhimit-te-Financave-Publike-2023-2030.pdf>
2. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (2021). Raport monitorimi. Transparenca dhe llogaridhënia në nivelin e qeverisjes vendore: Një vlerësim krahasues i programeve të transparencës në 12 bashki të vendit. Tiranë.
3. Qendra Res Publica. (2016). Konsultimi publik: Sfidat e vitit të parë të zbatimit të ligjit. Tiranë. <https://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2016/07/konsultimi-publik-sfidat-e-vitit-te-pare-te-zbatimit-te-ligjit.pdf>
4. Qendra Res Publica. (2019). Konsultimi publik 2017-2018. Tiranë. <https://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2019/04/Konsultimi-Publik-2017-2018-Res-Publica-NED.pdf>
5. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (2024). Zmbrapsja demokratike dhe tkurrja e hapësirës qytetare. Tiranë. https://idmalbania.org/wp-content/uploads/dlm_uploads/2024/04/Zmbrapsja-demokratike-dhe-tkurrja-e-hapesires-qytetare_shqip-Final.pdf
6. Vurmo, G. (2021). Ruajtja e Rojtarëve: Mbikëqyrja Parlamentare e Institucioneve të Pavarura në Shqipëri. Institute for Democracy and Mediation (IDM).
7. Vurmo, G. (2021). Deconstructing State Capture in Albania: An Examination of Grand Corruption Cases and Tailor-Made Laws from 2008 to 2020. Institute for Democracy and Mediation (IDM).
8. International Budget Partnership (IBP). (2023). Open Budget Survey: Albania. <http://www.internationalbudget.org>.
9. Ibid.
10. Local Government Association. (2016, December 12). Case study: Porto Alegre, Brazil. <https://www.local.gov.uk/case-studies/case-study-porto-alegre-brazil>
11. Rebecca Abers, Robin King, Daniely Votto and Igor Brandão, 2018, World Resources Institute, <https://www.wri.org/research/porto-alegre-participatory-budgeting-and-challenge-sustaining-transformative-change>
12. Urban Research Institute. (n.d.). Participatory budgeting in Albania. <http://uri.org.al/project/participatory-budgeting-in-albania/>
13. World Bank. (n.d.). Participatory budgeting. http://web.Worldbank.org/archive/ëebSite01337/ëEB/O__CON-4.HTM

14. Urban Research Institute. (2015). Indeksi i transparencës për buxhetin 2008 dhe 2009. <https://www.uri.org.al/new/wp-content/uploads/2015/04/Indeksi-i-Transparenc%C3%ABs-p%C3%ABr-Buxhetin-2008-dhe-2009.pdf>
15. Urban Research Institute. (n.d.). Participatory budgeting in Albania. <http://uri.org.al/project/participatory-budgeting-in-albania/>
16. World Bank. (2006). Participatory Budgeting Toolkit for Local Governments in Albania. Washington, DC: World Bank.
17. World Bank. (2010, April 23). World Bank supports empowerment of the marginalized and vulnerable groups in the development processes in Albania. <https://www.Worlbank.org/en/news/press-release/2010/04/23/World-bank-supports-empowerment-of-the-marginalized-and-vulnerable-groups-in-the-development-processes-in-albania>
18. Urban Research Institute. (2018). Mbështetja e 7 bashkive në hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, PBA, Instrumentit të Planifikimit Financiar (FPT), Paketës Fiskale dhe Buxhetit Vjetor. <https://www.uri.org.al/ëeb/wp-content/uploads/2018/04/Mb%C3%ABshtetja-e-7-bashkive-n%C3%AB-hartimin-e-Programit-Buxhetor-Afatmes%C3%ABm-2019-2021-PBA-Instrumentit-t%C3%AB-Planifikimit-Financiar-FPT-Paket%C3%ABs-Fiskale-dhe-Buxhetit-Vjetor-1.pdf>
19. Urban Research Institute. (2017). Studim krahasues: Menaxhimi i buxhetit dhe kapaciteti fiskal - Komunitat nga Rajoni i Korçës. <https://www.uri.org.al/web/wp-content/uploads/2017/03/STUDIM-KRAHASUES-%E2%80%9CMENAXHIMI-I-BUXHETIT-DHE-KAPACITETI-FISKAL%E2%80%9D-KOMUNITAT-NGA-RAJONI-I-KOR%C3%87%C3%8BS..pdf>
20. Urban Research Institute. (2015). Lobing për rritjen e fondeve për sektorin e bujqësisë nga buxheti. <https://www.uri.org.al/new/wp-content/uploads/2015/07/Lobing-per-rritjen-e-fondeve-per-sektorin-e-bujqesise-nga-buxheti-i.pdf>
21. Partners Albania. (2015). Buxhetimi me pjesëmarrje në nivel qendror: Raport përmbledhës. Tiranë: Partners Albania.
22. World Bank. (2012, September 10). Participatory budgeting: An experience in good governance. <https://www.Worlbank.org/en/neës/feature/2012/09/10/participatory-budgeting-an-experience-in-good-governance>
23. UN Women. (2023, November). Advancing gender-responsive budgeting in Albania. <https://albania.unwomen.org/en/neës-and-events/stories/2023/11/advancing-gender-responsive-budgeting-in-albania>
24. Fletorja Zyrtare, Ligji 9936/2008 “Për menazhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjin n.57/2016
25. Fletorja Zyrtare, Ligji 68/2017 “Ligjin për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
26. UN Women. (2023, November). Advancing gender-responsive budgeting in Albania. <https://albania.unëomen.org/en/neës-and-events/stories/2023/11/advancing-gender-responsive-budgeting-in-albania>

27. Ibid.
28. Ibid.
29. Fletorja Zyrtare, Ligji 9970/2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”
30. UN Women. (2023). Angazhimi i parlamentit në buxhetimin e përgjigjshëm gjinor. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-06/angazhimi_i_parlamentit_ne_buxhetimin_e_pergjigjshem_gjinor_2023_ëeb.pdf
31. UN Women. (2024). Transformative results. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-10/6._unë_transformative_results_revised_ii.pdf
32. UN WOMEN ALBANIA STRATEGIC NOTE 2022-2026, 2022. chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-02/strategic%20note_feb22.pdf
33. UN Women. (2024, June). watchdog reports: Gender-responsive budgeting implementation. <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2024/06/watchdog-reports-gender-responsive-budgeting-implementation>
34. AIS/Open Data Albania. (2020). Analiza e kontratave të prokurimit gjatë pandemisë COVID-19. Tiranë: AIS.
35. AIS/Open Data Albania. (2021). Raporti vjetor i aktiviteteve 2020. Tiranë: AIS.
36. Albanian Institute of Science. (2022). Kontrolli financiar dhe procesi i hapjes së negociatave për Kapitullin 32. Disponueshëm në: https://ais.al/wp-content/uploads/PP_VERSION_SHQIP_FINAL_Kontrolli-financiar-dhe-procesi-i-hapjes-se-negociatave-per-Kapitullin-32.pdf
37. AIS/Open Data Albania. (2023). Trajnimet për Monitorimin Buxhetor. <http://www.ndiqparate.al>.
38. Albanian Institute of Science. (2024). Forcimi i kulturës së monitorimit: Trajnim mbi monitorimin e shpenzimeve dhe kontraktive publike në qeverisjen vendore - Has. Disponueshëm në: <https://ais.al/new/forcimi-i-kultures-se-monitorimit-trajnim-mbi-monitorimin-e-shpenzimeve-dhe-kontraktive-publike-ne-qeverisjen-vendore-has/>
39. AIS/Open Data Albania. (2024). Projektet anti-korrupsion në mungesë fondesh dhe donatori. Tirane:AIS. 2024. Disponueshëm në: <https://ndiqparate.al/?p=21089>
40. Europartners. (2020). Për një qeverisje lokale transparente: Raport përfundimtar. Tiranë: Europartners.
41. Qendra Kombëtare Burimore. (2021). Fushata “Buxheti ynë, zëri ynë”. Tiranë: Qendra Kombëtare Burimore.
42. Down Syndrome Albania. (2025). Buxheti i Bashkisë Tiranë për personat me aftësi të kufizuara 2024. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.
43. Zhebo, E., Kaleshi, E., & Zika, R. (2025). Rritja e llogaridhënies dhe transparencës buxhetore në planet vendore të veprimit për energjinë dhe klimën. Instituti për Ndryshim dhe Lidërsip në Shqipëri

44. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri. (2024). Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të OSHC-ve në Shqipëri.
45. Ibid.
46. Down Syndrome Albania. (2023). Raporti i monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025. Tiranë: DSA.
47. Down Syndrome Albania. (2022). Raporti i monitorimit të shërbimeve sociale në Bashkinë Tiranë. Tiranë: DSA.
48. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). (2019). Monitorimi i buxheteve lokale: Gjetje dhe rekomandime. Tiranë: IDM.
49. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). (2020). Raporti i progresit të programit BAT. Tiranë: IDM.
50. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). (2019). BAT Civil Society - Civic Oversight Capacities for Budget Accountability and Transparency. Tiranë: IDM. <https://idmalbania.org/news-cpt/bat-civil-society-civic-oversight-capacities-for-budget-accountability-and-transparency/>
51. Qendra për Demokraci dhe Zhvillim (QDA). (2023). Analiza e buxhetit të Bashkisë Durrës: PBA 2024-2026. Tiranë: IDM.
52. Zhebo, E., Kaleshi, E., & Zika, R. (2025). Rritja e llogaridhënies dhe transparencës buxhetore në planet vendore të veprimit për energjinë dhe klimën. Instituti për Ndryshim dhe Leadership në Shqipëri.
53. Lëvizja Rinore për të Drejtat e Romëve dhe Egjiptianëve (LRER). (n.d.). Sfidat e punësimit dhe vlerësimi i dokumenteve strategjike: Analiza e PBA 2025-2027 për çështjet e punësimit, me fokus kryesor te komunitetet Rome dhe Egjiptiane.
54. Caushaj, R. (2025). Buxheti i Bashkisë Tiranë për personat me aftësi të kufizuara 2024. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.
55. Albanian Helsinki Committee. (2024). Contribution and challenges of civil society in Albania. https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2024/11/Contribution-and-challenges-of-Civil-society-in-Albania_C1EU-NPA.pdf
56. Civil Society Index Albania. (2020). Raporti mbi gjendjen e shoqërisë civile në Shqipëri. Tiranë: IDMC
57. Ndiq Paratë. (n.d.). Pjesëmarrje në vendimmarrje për buxhetin në nivel vendor. <https://ndiqparate.al/?p=21089>
58. Civil Society Index Albania. (2020). Raporti mbi gjendjen e shoqërisë civile në Shqipëri. Tiranë: IDMC
59. Qendra Kombëtare Burimore. (2023). Raport mbi Financimin e OShC-ve.

60. Civil Society Index Albania. (2020). Raporti mbi gjendjen e shoqërisë civile në Shqipëri. Tiranë: IDMC
61. UNDP. (2023). Opinion poll 2023 - Albania. https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2024-05/opinion_poll_2023_-_al_0.pdf
62. IDM Albania. (2014). Civil society and the EU accession process. https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/11/cs-eu-accession-process_final.pdf
63. CIVICUS. (n.d.). Civil society index: Albania. https://www.civicus.org/images/stories/csi/csi_phase2/csi%20albania%20acr_eng.pdf
64. BIRN Albania. (2022). Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrjen lokale. Tiranë: BIRN.
65. Albanian Helsinki Committee. (2024). Contribution and challenges of civil society in Albania. https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2024/11/Contribution-and-challenges-of-Civil-society-in-Albania_C1EU-NPA.pdf
66. Civil Society Index Albania. (2020). (2020). Raporti mbi gjendjen e shoqërisë civile në Shqipëri. Tiranë: IDMC.
67. European Commission. (2023). EU Growth Plan for the Western Balkans. https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_23_5671
68. Open Government Partnership (OGP). (2020). Albania Action Plan Review 2020-2022. www.opengovpartnership.org
69. Bëhet fjalë për Vulekamali, një projekt i Zyrës Kombëtare të Thesarit të Afrikës së Jugut dhe Imali Yethu (Koalicioni i Shoqërisë Civile për Buxhete të Hapura) me qëllim që të dhënat dhe proceset e buxhetimit të jenë të arritshme për të gjithë qytetarët dhe palët e interesuara. Linku: <https://vulekamali.gov.za/>
70. Macroeconomic and Financial Data, Statistical office of the Republic of Serbia. Link: <https://www.stat.gov.rs/en-US/NSDP-Serbia>
71. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (2021). E drejta për informim. <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Broshure-E-drejta-per-Informim-3.pdf>
72. Gardawski, J. (2018). Dialogue and Social Partnership in Poland: From Tripartite Commission to Social Dialogue Council. Warsaw School of Economics.
73. Healy, S., & Reynolds, B. (2025). Social Justice Ireland: Socio-Economic Review 2025. Social Justice Ireland. <https://www.socialjustice.ie>
74. Down Syndrome Albania. (2022). Raporti i monitorimit të shërbimeve sociale në Bashkinë Tiranë. Tiranë: DSA.



Institute
for Democracy
and Mediation